

Është hapur thirrja për kategorinë “Qarkullimi i veprave letrare evropjane” të Evropës Kreative

Thirrja për kategorinë "Qarkullimi i veprave letrare evropiane" (CREA-CULT-2024-LIT) është e hapur, me afat për dorëzimin e propozim-projekteve më 16 prill 2024, deri në orën 17:00 (CET).

Për thirrjen janë siguruar 5.000.000 euro dhe pritet të mbështeten 40 projekte.

Kjo mbështetje e nënprogramit- Kultura e Bashkimit Evropian synohet për projekte që përfshijnë përkthimin, botimin, shpërndarjen dhe promovimin e veprave letrare evropiane, autorët e të cilave janë qytetarë ose banorë të vendeve pjesëmarrëse në programin Evropa Kreative ose janë pjesë e trashëgimisë së tyre letrare.

<https://culture.ec.europa.eu/news/creative-europe-to-support-40-projects-in-2024-to-boost-literary-translations>

Temat dhe prioritetet konkrete të thirrjes

- Përforcimi i qarkullimit dhe transnacional dhe llojlojshmërisë së veprave letrare evropiane
- Nxitja e përkthimit, botimit dhe promovimit të veprave letrare të shkruara në gjuhët më pak të përhapura me qëllim rritjen e qarkullimit të tyre në tregjet më të mëdha në Evropë dhe më gjerë
- Zhvillimi dhe nxitja e lexuesve të tjerë, me fokusin te të rinjtë.
- Promovimi dhe ruajtja e profesionit të përkthimit letrar, duke përfshirë parimet e përmirësimit të kushteve të mira të punës dhe përfaqësisë (në këtë kuptim, botuesit nxiten të sigurojnë dukshmërinë e përkthyesve në librat e botuar).
- Përforcimi i konkurrencës së sektorëve të librit dhe botimeve duke nxitur bashkëpunime të ndryshme brenda sektorit (veçanërisht libraritë dhe bibliotekat).
- Mbështetja për sektorin letrar ukrainas – nxiten projekte që do të ofrojnë libra në gjuhën ukrainase për refugjatët dhe të ndjekurit ukrainas.

Propozim-projektet duhet të trajtojnë gjithashtu çështje ndër-sektoriale – përfshirjen dhe llojlojshmërinë, barazinë gjinore dhe planin e gjelbër.

Aplikantët e kualifikuar

Personat juridikë (privat ose publik) të regjistruar në vendet pjesëmarrëse në programin Evropa Kreative. Propozim-projektet e paraqitura nga aplikantë individualë janë të kualifikuar si dhe nga një konsorcium që duhet të përbëhet nga të paktën dy organizata partnere që nuk janë subjekte të lidhura. Koordinatorin duhet të ekzistojë ligjërisht të paktën 2 vjet para afatit të aplikimit dhe të jetë aktiv në sektorin e botimeve dhe librit.

Aktivitetet e kualifikuar

Përkthimi, botimi, promovimi dhe shpërndarja e veprave dhe veprimtarive letrare evropiane që korrespondojnë me temat dhe prioritetet.

Llojet e projekteve/kategorive

Të vogla – përkthime të të paktën 5 titujve të ndryshëm, grant i BE-së deri në 100,000 euro (60% e buxhetit total të projektit).

Të mesme – përkthime të të paktën 11 titujve të ndryshëm, grant i BE-së deri në 200,000 euro (60% e buxhetit total të projektit).

Të mëdha – përkthime të të paktën 21 titujve të ndryshëm, grant i BE-së deri në 200,000 euro (60% e buxhetit total të projektit).

Granti total i dhënë për projekt nuk mund të kalojë 200,000 euro për aplikantët individualë dhe 300,000 euro për propozimet e dorëzuara në konsorciume të të paktën dy organizatave të kualifikuara.

Ndikimet e pritura

Propozime- projektit duhet të bazohen në strategji të shëndoshë redaktuese dhe promovuese që përfshin pako prej të paktën 5 tituj të përkthyer nga dhe në gjuhët e kualifikuar dhe t'i përmbajë elementët e mëposhtëm:

- kontribut në llojllojshmërinë e letërsisë në një vend (ose vende) të caktuar duke përfshirë vepra letrare nga vende të përfaqësuara pamjaftueshëm, me theks të veçantë në veprat e shkruara në gjuhët më pak të përdorura;
- formati i zgjedhur i librit dhe strategjia e shpërndarjes që siguron qasje të gjerë dhe të lehtë në veprat letrare evropiane për publikun e gjerë;
- strategji promovimi që kontribuon në zgjerimin, zhvillimin dhe ripërtëritjen e publikut lexues;
- nxitja e bashkëpunimit ndërmjet autorëve, përkthyesve, botuesve, shpërndarësve, librarive, bibliotekave, festivaleve, ngjarjeve letrare, etj.;
- kontribut në ngritjen e profilit të përkthyesve dhe respektimin e parimeve të kompensimit të drejtë;
- kontributi në çështjet ndër-sektoriale të programit dhe prioritetet e theksuara në programin e punës për vitin 2024 (barazia gjinore dhe plani i gjelbër).

Mënyra e përgatitjes, përpunimit dhe dorëzimit të propozime-projekteve/aplikacioneve

- Propozim-projektet përgatiten në pajtim me kriteret dhe kushtet e përcaktuara në dokumentin e thirrjes: Call for proposals Circulation of European Literary Works (CREA-CULT-2024-LIT), Version 1.0, 16 January 2024, që mund ta merrni në: https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/opportunities/docs/2021-2027/crea/wp-call/2024/call-fiche_crea-cult-2024-lit_en.pdf

- Aplikimet përpunohen dhe dorëzohen në mënyrë elektronike përmes **Funding &Tenders Opportunity Portal (F&TP)**:
<https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/opportunities/portal/screen/opportunities/topic-details/crea-cult-2024-lit?closed=true&programmePeriod=2021%20-%202027&frameworkProgramme=43251814&callIdentifier=CREA-CULT-2024-LIT>
- Informacione mbi qasjen në F&TP mund të gjeni në:
https://www.eacea.ec.europa.eu/grants/how-get-grant_en